

KONTRATË SHITJE (Kuotat e Kapitalit)

Sot, më datë 05/08 /2025 në selinë e shoqërisë “EN CONSTRUCTION” sh.p.k u paraqitën palët si më poshtë:

SHITËS:

Znj. Majlinda Pernoci shtetase shqiptare, lindur në Shijak dhe banuese në Tiranë, lindur më 11.03.1973, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me anë të Letërnjoftimit ID me nr. 034475499 dhe nr. personal H35311050E

Z. Agron Hyseni shtetas shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, lindur më 02.06.1969, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me anë të Pasaportës me nr. BG8588738 dhe nr. personal G90602056L

*(këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si **shitësi/shitësat**.)*

BLERËS:

Z. Shkëlqim Beshiri shtetas Shqiptar, lindur me 15.08.1976 ne Tirane, me rezidence Tirane, identifikuar me anë të Letërnjoftimit ID me nr. 035351706 dhe nr. personal H65815060D

*(këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si **Blerësi**.)*

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësit dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

Kushtet paraprake

- A) Shitësja **Majlinda Pernoci** është ortak themelues dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 16.50 % (gjashtëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë “**En Construction**” sh.p.k, person juridik, regjistruar me NIPT M36808207V, me seli ne Lagjia “Uji i ftohtë”, rruga “Murat Terbac”, Kompleksi Oslo, objekti nr. 2, Z.k. 8602,Vlorë, perfaqesuar nga Administratori Z. Klaudio Caushaj, Shqipëri (në vijim referuar edhe si “**Shoqëria**”);
- B) Shitësi **Agron Hyseni** është ortak themelues dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 16.50 % (gjashtëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë “**En Construction**” sh.p.k, person juridik, regjistruar me NIPT M36808207V, me seli ne Lagjia “Uji i ftohtë”, rruga “Murat Terbac”, Kompleksi Oslo, objekti nr. 2, Z.k. 8602,Vlorë, perfaqesuar nga Administratori Z. Klaudio Caushaj, Shqipëri (në vijim referuar edhe si “**Shoqëria**”);
- C) Shitësat dëshirojnë t'i shesin Blerësit nga 1 (një) kuote secili, kuota e secilit është e barabartë me 16.50 % (gjashtëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, dhe të cilët sëbashku përbëjnë 33 (tridhjetë e tre përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë (në vijim referuar edhe si “**Kuotat**”), sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim;

- D) Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësat 2 (dy) Kuota të barabartë me 33 (tridhjetë e tre përqind) të totalit të kapitalit themeltar të Shoqërisë, e ndarë në një kuotë me vlerë 16.50 % (gjashtëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë përqind) secili, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme;
- E) Më datë 05.08.2025 përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, asambleja e përgjithshme e Shoqërisë, ka miratuar transferimin e Kuotave respektive për dy ortakët themelues.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Kushtet paraprake

Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

Neni 2


Shitja e kuotës

- 2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi Majlinda Pernoci bie dakort te shese, transferoje dhe dorezoje 1 (nje) kuote e barabarte me 16.50 % (gjashtëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë përqind) te pjesemarrjes te kapitalit themeltar qe ajo zoteton ne shoqerine "EN CONSTRUCTION" sh.p.k, të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili, pranon dhe blen, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.
- 2.2. Shitësi Agron Hysei bie dakort te shese, transferoje dhe dorezoje 1 (nje) kuote e barabarte me 16.50 % (gjashtëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë përqind) te pjesemarrjes te kapitalit themeltar qe ai zoteron ne shoqerine "EN CONSTRUCTION" sh.p.k, të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili, pranon dhe blen, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë
- 2.3. Shitja dhe transferimi i titullit te kuotes behet me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe dorezimin e kuotes tek bleresi, i cili merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e shitesave dhe ne veçanti te drejten per te marre pjese ne fitimet e shoqerise, per te ndare pasurine e shoqerise si dhe merr persiper detyrimet dhe pasivet e mundeshme. Palet bihen dakort se pagesa e çmimit do te behet sipas percaktimeve te nenit 3 te kesaj kontrate. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësit bin dakort dhe bleresi pranon sa me siper dhe behet pronar i 16.50 % te cdo te drejte per secilin prej shitësve, pra në total 33% (tridhjetë e tre) përqind te aseteve te inventarizuara dhe pasurie qe zoteron shoqeria "EN CONSTRUCTION" sh.p.k.,
- 2.4. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, **struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë "EN CONSTRUCTION" sh.p.k, do te jete:**
- a) **Gramoz Qëndro** zoterues i 1 (një) kuote e cila konsiston ne 33% te kapitalit themeltar, me vleren te pergjithshme 330,000 (treqind e tridhjetë mijë) lekë.
 - b) **Klaudio Caushaj** zoterues i 1 (një) kuote e cila konsiston ne 34% te kapitalit themeltar, me vleren te pergjithshme 340,000 (treqind e dyzet mijë) lekë
 - c) **Shkëlqim Beshiri** zoterues i 1 (një) kuote e cila konsiston ne 33% te kapitalit themeltar, me vleren te pergjithshme 330,000 (treqind e tridhjetë mijë) lekë

Neni 3

Çmimi

- 3.1 Çmimi i shitjes i kuotës 1 (nje) kuote e barabarte me 16.50 % (gjashtëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë përqind) objekt i kësaj kontrate shitje, do te jete ne vleren prej 165,000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë) Leke . Çmimi total i i shijtes se kuotave për 2 kuotat objekt i kësaj kontrate shitje, i cili është likujduar më herët



nëpërmjet palëve, është në vlerën 330,000 (treqind e tridhjetë mijë) lekë e cila konsiston në 33% të kapitalit themeltar.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci të Shitësit

- 4.1 Shitësi garanton Blerësin se është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.
- 4.2 Shitësi garanton Blerësin se Kuota objekt i kësaj Kontrate, është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 4.3 Blerësi deklaron se blen Kuotën e Shitësit, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 4.4 **Shitësit me nënshkrimin e kësaj kontrates deklarojnë se nuk kanë dhe nuk do të kenë asnjë pretendim në lidhje me kuotat e pjesëmarrjes të kapitalit themeltar të shoqërisë "EN CONSTRUCTION" që ata zoteronin.**
- 4.5 Kjo kontratë do të jetë e detyrueshme dhe do të ketë pasoja juridike ndaj palëve, trashëgimtareve të tyre, si dhe ndaj atyre të cilëve iu është ceduar në mënyrë të rregullt.

Neni 5

Shpenzimet dhe taksat

- 5.1 Shpenzimet e tjera do të paguhen nga palet sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 6

Interpretimi i kontratës

Nese pjesë të kësaj kontrate janë ose behen të pavlefshme ose jodetyruese, palet do të jenë të detyruara të zbatojnë pjesën tjetër të kontratës. Në këtë rast, palet do të zvendesojnë pjesën e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime të vlefshme e detyruese efektet e të cilave sipas përmbajtjes dhe qëllimeve të kësaj kontrate duhet të jenë në kufijte e të mundshmes, e ngjashme me pjesën e pavlefshme ose jodetyruese.

NENI 7

Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen, direkt ose indirekt, midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj kontrate palët paraprakisht duhet të diskutojnë në lidhje me këto mosmarrëveshje për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet një marrëveshje sipas parashikimeve të bëra në këtë nen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 8


LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Palëve.

Neni 9

Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e 2 (dy) kuotave të barazvlefshme me 33% (tridhjetë e tre përqind) të pjesëmarrjes të kapitalit themeltar që zoterojnë shitesat, tek Blerësi dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo deklaratimet e mëparshme në lidhje me objektin në



fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

Neni 10

Anekset e kontrates

Kesaj kontrate i bashkengjiten si pjese perberese dhe te pandara keto dokumenta qe do te quhen Anekse te kontrates. Pjesë përbërëse të kësaj kontrate është dhe dokumentacioni bashkangjitur:

- Ekstrakti i Regjistrimit Tregetar
- Vendimi i Asamblese se Pergjithshme.

Neni 11

Dispozitat Përfundimtare

Kontrata e Shitjes pasuri e luajtshme - *Kuota te kapitalit*, u lexua me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të *Palëve*, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht atë.

Kontrata u hartua në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese.

SHITES

Majlinda Pernoci

Agron Hyseni

BLERES

Shkëlqim Beshiri